

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-040/12

Prishtinë, 20 qershor 2012

Në çështjen juridike civile të

B. I.
Obiliq

Pala ankuese

Kundër

D. C.
Bajina 524
6247 Račica
Kralejë
Serbi

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Antarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/51/2009, lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA22371, të datës 18 gusht 2009, pas shqyrtimit të mbajtur me 20 qershor 2012, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Hedhet poshtë si e papranueshme ankesa e B. I.
 - 2- kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/51/2009 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA22371), të datës 19 gusht 2009.
- 2- Obligohet pala ankuese B. I. që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë euro), të cilat duhet të paguhet në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 01 mars 2007, D. C. duke vepruar si anëtar i familjes së ngushtë të M. C., ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) në lidhje me ngastrën nr. 1675, të evidentuar si arë me sipërfaqe prej 2 ha, 47 ari e 78 m², që gjendet në Dragodan, Obiliq.

Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se ai është fëmija i pronarit të ndjerë të pronës dhe se pronësia ishte humbur me 1 qershor 1999 si rezultat i konfliktit të armatosur në vitet 1998/1999. Ai ka pohuar se prona ishte uzurpuar nga një person i panjohur dhe ka kërkuar ri-posedimin e saj.

Për të mbështetur kërkesën e tij, ai ia ka paraqitur në AKP dokumentet e mëposhtme:

- Fletën Poseduese nr. 94, të lëshuar me 4 prill 2012 nga zyra kadastrale e Republikës së Serbisë në emër të C. D. M.;
- Certifikatën e vdekjes së M. C.;
- Kontratën mbi dhurimin, të lidhur ndërmjet C. M. dhe C. D., të datës 21 gusht 2001 dhe të certifikuar në Gjykatën Komunale në Krlevë me 21 gusht 2001;
- Ekstraktin nga fleta poseduese nr. 186 të datës 08 nëntor 1963, të lëshuar nga komuna kadastrale e Obiliqit në emër të C. D. M.;

Më 09 nëntor 2007, zyrtarët e AKP-së kanë shkuar në vendin ku supozohej se ndodhej ngastra dhe kanë vendosur lajmërimin që tregonte se prona ishte objekt i kërkesës. Sipas raportit të njoftimit ngastra është gjetur e uzurpuar nga një person i panjohur dhe ishte tokë e punuar. Në vitin 2010, Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së e ka kontrolluar njoftimin e vitit 2007 duke përdorur gps-in dhe ortofotot dhe ka konfirmuar

saktësinë e tij. Sipas raportit të datës 09 mars 2010, dhe kopjes së hartës kadastrale, në ditën e njoftimit – 09 mars 2007 lajmërimi ishte vendosur saktësisht në ngastrën 1675. Harta kadastrale tregon se ngastra nr. 1675 është një arë dhe aty ekziston një ndërtesë e cila gjendet në vijën e kufirit ndërmjet ngastrës 1675 dhe ngastrës fqinje ë anën e lindore (pjesa e ulët).

Brenda 30 ditëve nga njoftimi, Sekretaria Ekzekutive nuk ka pranuar informacione se ndonjë person tjetër (i ndryshëm nga paraqitësi i kërkesës) do të kishte për qëllim që të marrë pjesë në procedurë.

Me 18 gusht 2009, KKPK-ja me vendimin e tij KKPK/D/A/51/2009 (që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA22371) vendos se kërkesa e D. C. ishte e bazuar, dmth. se bartësi i të drejtës pronësore ishte pronar i pronës së kërkuar.

Me 23 nëntor 2010, është nxjerrë një vendim individual për identifikimin e pronës së kërkuar.

Me 24 janar 2012, B. I. (tani e tutje ‘pala ankuese’) ka paraqitur ankesë kundër vendimit të lartpërmendur duke pohuar se babai i tij e kishte blerë këtë pronë nga M. C. në vitin 1970 dhe e kishte shfrytëzuar atë që nga ajo kohë. Ai pohon se shtëpia në të cilën jeton ishte ndërtuar në ngastrën kontestuese dhe se gjendet një bagrem dhe drunj tjerë të cilët ishin mbjellë para 30 viteve. Ai sqaron se ka dëgjuar për kontestin aktual për herë të parë në shtator të vitit 2011.

Me 24 prill 2012, paraqitësi i kërkesës, tani pala përgjegjëse në ankesë kishte paraqitur një përgjigje në ankesë, duke cekur se ankesa është e papranueshme dhe e pabazuar në meritat e saj.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e papranueshme, pasi që është paraqitur nga person i cili nuk ka pasur të drejtë ta paraqesë atë.

Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 parasheh se çdo person, përveç paditësit, i cili pretendon se ka të drejtë në pronën e kontestuar është palë në këtë kërkesë dhe në procedurat me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda 30 ditëve nga njoftimi për kërkesën.

Ligji në nenin 10.1 po aty parasheh se Sekretaria “bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën”. Ai nuk ofron një përshkrim specifik se çfarë nënkuptohet me “përpjekje të arsyeshme” përveç se “në rastet e duhura, përpjekjet e tilla të arsyeshme do të jenë në formë të një lajmërimi në një botim zyrtar”. Interpretimi gramatikor i këtij teksti nxjerrë konkludimin se publikimi është më tepër është një përjashtim sesa rregull dhe se vetë rregulla duhet të

kufizohet në bazë të logjikës së zakonshme dhe zakoneve ekzistuese. Deri me tani është pranuar nga Gjykata se sipas rregullës njoftimi është bërë duke vendosur një lajmërim (tabelë) me informacionet lidhur me kërkesën në 3 gjuhë (anglisht, shqip dhe serbisht) në pronën në fjalë dhe për aq kohë sa shenja është vendosur në vendin/objektin e duhur – ngastër, shtëpi, etj., njoftimi konsiderohet si i kryer në mënyrë të saktë dhe konsiderohet se palët e mundshme të interesuara janë informuar me kohë për procedurën para AKP-së, përveç nëse ekziston ndonjë arsye që të besohet ndryshe.

Në rastin e tanishëm, njoftimi ishte vendosur në ngastrën kontestuese dhe nuk ka ndonjë sqarim të arsyeshëm se përse pala ankuese nuk ka mundur ta shoh shenjën dhe rrjedhimisht ta njoftojë Sekretarinë për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurë. Ai pohon se kishte mësuar për kontestin në shtator të vitit 2011 por shumë ka gjasa që të mos jetë kështu duke marrë parasysh se sipas deklaratës së palës ankuese në ankesën e tij, ai jeton në shtëpi në të njëjtën ngastër. Nuk ka gjasa që shtëpia e tij të gjendet në të njëjtën ngastër pasi që në ngastrën kontestuese nuk ka ndërtesa, më përjatshim të një objekti që gjendet ndërmjet ngastrës 1675 dhe asaj fqinje në anën lindore, siç mund të shihet nga harta kadastrale e datës 09 mars 2010. E vetmja mundësi është që ndërtesa të jetë shtëpia të cilës i referohet pala ankuese.

Në të dy rastet, pala ankuese ose është duke pretenduar të drejtat ndaj ngastrave të ndryshme (nëse shtëpia e tij nuk gjendet në ato të kontestuara) ku në këtë rast ai nuk ka interes ligjor në lëndën aktuale apo, nëse është e vërtetë se shtëpia gjendet në kufirin ndërmjet ngastrës 1675 dhe ngastrës lindore fqinje, atëherë ai e ka parë shenjën e njoftimit, të vendosur aty me 9 nëntor 2007 dhe është dashur ta njoftojë Sekretarinë ashtu siç parashihet në nenin 10.2 po aty. Përderisa ai nuk e ka bërë këtë dhe nuk ka marrë pjesë në procedurë ndonëse ishte njoftuar me kohë, ai nuk ka të drejtë ankese kundër vendimit të KKPK-së.

Prandaj ankesa hedhet poshtë si e papranueshme mbi bazën procedurale (nenin 13.3 nënparagrafi (b) i Rregullores së UNMIK-ut e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079 në lidhje me nenin 12.2 po aty dhe neni 196 i Ligjit për Procedurën Kontestimore).

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €;
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21,10.15 dhe 10.1 të UA 2008/2): 30 €.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin.

Në përputhje me nenin 45.1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, taksat nga tarifa gjyqësore duhet të paguhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës duke përfshirë edhe gjobën siç parashihet me nenin 47 të të njëjtit ligj.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it